REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.87, datë 29.10.2026

"PËR MIRATIMIN E VENDNDODHJES SË STACIONIT TË TRANSFERIMIT TË MBETJEVE, BASHKIA SKRAPAR"

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 29.10.2026, mori në shqyrtim projektaktin në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar , ligjit nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Ligjit nr. 57/2025 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve" , Deklaratës Mjedisore nr. 4774 prot, datë 03.07.2020, nga Ministri i Mjedisit dhe Turizmit, për projektin: "Plani Rajonal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, Qarkut Berat", Vendimit nr. 13, datë 30.10.2020, të Këshillit të Qarkut Berat, "Për Miratimin e Planit Rajonal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, të Qarkut Berat" , Vendimin nr. 2, datë 08.02.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit, "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, të Bashkisë Skrapar", si dhe në kuadër të zbatimit të projektit: "Menaxhimi i Qëndrueshëm dhe Miqësor me Klimën në Sektorin e Mbetjeve të Ngurta", financuar nga KFW, zbatuar nga Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve,

VENDOSI:

Miratimin e vendndodhjes së Stacionit të Transferimit të Mbetjeve, në pasurinë nr. 267, me sipërfaqe 388.500m^2 , Z.K 3756, Vërzhezhë, fshati Orizaj, Bashkia Skrapar"

Vendimi u miratua me 13 Vota pro, vota kundër - s'ka , abstenim – s'ka

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK
Elsa PETRITAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SKRAPAR